

VENDIM
Nr. 29, datë 15.5.2014

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja kryetar i Gjykatës Kushtetuese

Vladimir Kristo anëtar i “ “

Sokol Berberi anëtar i “ “

Vitore Tusha anëtare e “ “

Fatmir Hoxha anëtar i “ “

Gani Dizdari anëtar i “ “

Besnik Imeraj anëtar i “ “

Fatos Lulo anëtar i “ “

Altina Xhoxhaj anëtare e “ “

me sekretare Edmira Babaj, në datat 10.10.2013, 31.10.2013, 16.1.2014 dhe 6.2.2014 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr.38/11 Akti, që i përket palëve:

KËRKUESE: Elmoza Gorja

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Shoqëria “Baja” sh.p.k., Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Tiranë, Këshilli i Rregullimit të Territorit, Bashkia Tiranë

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, i vendimeve nr.5150, datë 4.6.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr.1067, datë 24.9.2009 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.00-2012-1299, datë 1.6.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 41, 43, 131/f dhe 133 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; ligji nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes, Altina Xhoxhaj, shqyrtoi dokumentet e paraqitura dhe pasi bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuesja Elmoza Gorja është një nga trashëgimtarët e shtetasit Xh.P., të cilit, me vendimin nr. 812, datë 21.10.1994, të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (KKKP) Tiranë, i është njohur e drejta e pronësisë mbi një sipërfaqe truall prej 20.000 m², duke u kthyer si truall i lirë një sipërfaqe prej 4.700 m² dhe duke u kompensuar për një sipërfaqe prej 15.300 m², kurse me vendimin nr. 283, datë 26.8.2000 të KKKP-së Tiranë është vendosur t’i kthehet si truall i lirë një sipërfaqe prej 1.685,3 m² dhe të kompensohet për sipërfaqen prej 13.614,7 m².

2. Në vitin 2005, trashëgimtarët e subjektit të shpronësuar i janë drejtuar KKKP-së Tiranë, duke kërkuar që t’u kthehet si truall i lirë edhe një sipërfaqe prej 400 m², e cila përfshihet në sipërfaqen e truallit të kthyer si të lirë me vendimin nr. 812, datë 21.10.1994 të KKKP-së. Kjo kërkesë i është kaluar për shqyrtim Komitetit Shtetëror të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (KSHKKP), i cili me vendimin nr. 128, datë 31.5.2006 ka vendosur rrëzimin e kërkesës, me arsyetimin se 200 m² është i zënë me ndërtim të përhershëm (sipërfaqja funksionale e tij) dhe 146 m² është e zënë me trotuar dhe rrugë.

3. Në këto kushte, kërkuesja ka zgjedhur rrugën gjyqësore për kundërshtimin e vendimit të mësipërm të KSHKKP-së dhe detyrimin e palës së paditur (Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave) që t’i kthejë, trashëgimtarëve të ish pronarit Xh.P., sipërfaqen prej 200 m² truall të lirë, e ndodhur brenda sipërfaqes prej 13.614,7 m² (të miratuar për kompensim), duke e zbritur atë nga kjo e fundit.

4. Me vendimin nr. 5150, datë 4.6.2008, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur rrëzimin e kërkesë padisë.

5. Me vendimin nr. 1067, datë 24.9.2009, Gjykata e Apelit Tiranë ka lënë në fuqi vendimin e mësipërm të gjykatës së shkallës së parë. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë kërkuesja Elmoza Gorja.

6. Me vendimin nr. 00-2012-1299, datë 1.6.2012, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në dhomë këshillimi, ka vendosur mospranimin e rekursit, për arsye se ai nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 472 të KPC-së.

II

7. **Kërkuesja Elmoza Gorja** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese, me kërkesë për shfuqizimin e vendimeve gjyqësore të tri shkallëve të gjyqimit, duke paraqitur këto shkaqe:

7.1. Kërkesëpadia është paraqitur brenda afateve ligjore, në ndryshim nga sa parashitrojnë gjykatat. Neni 328 i KPC-së parashikon se afati 30-ditor i ankimit fillon nga marrja dijeni të aktit dhe jo nga shpallja e tij. Gjatë hetimit gjyqësor asnjë nga palët nuk arriti të provojë datën e marrjes dijeni të vendimit të organit administrativ nga ana e kërkuarës. Gjykata nuk mundet ta llogarisë këtë afat pa pasur një provë (me shkresë) ku konfirmohet njoftimi i aktit.

7.2. Konflikti gjyqësor lidhet edhe me faktin se shoqëria ndërtuese e objektit mbi truall ka dalë jashtë kufijve të lejes së ndërtimit të miratuar. Në këto kushte, kërkesa për zgjidhjen e këtij konflikti civil nuk ka afat.

7.3. Në ligjin për kthimin dhe kompensimin e pronës nuk ka afate të caktuara për ankimin ndaj vendimeve të KSHKKP-së. Në këtë rast kemi të bëjmë me një mbivendosje të pronës së pretenduar, pra kemi të bëjmë me një vendim administrativ të pavlefshëm që nuk sjell pasoja. Ky akt administrativ është i pavlefshëm edhe për arsye se atij i mungojnë ekstremitetet ligjore, nuk është firmosur nga titullari i institucionit dhe, si i tillë, nuk ka afat për goditjen e tij.

7.4. Gjykatat kanë treguar njëanshmëri në favor të palëve të paditura në gjykim dhe provat e paraqitura nga kërkuarësja nuk janë vlerësuar e shqyrtuar nga gjykatat. Gjykata e shkallës së parë është bazuar mbi një akt ekspertimi të pamiratur nga ekspertja dhe pa plotësuar detyrat e lëna nga gjykata, si dhe nuk ka pranuar kërkesën e kërkuarës për përsëritjen e ekspertimit.

7.5. Në vendimin e saj, fillimisht gjykata shprehet se ekspertët kanë dalë në konkluzionin se nuk ka mbivendosje dhe më pas shprehet se ka mbivendosje mes pronave.

7.6. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, duke anashkaluar kërkesat ligjore të paraqitura në rekurs dhe duke vendosur mospranimin e tij, i ka cenuar kërkuarës të drejtën e pronës dhe të drejtën për t'u dëgjuar në një proces të rregullt.

8. **Subjekti i interesuar Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (AKKP)**, përfaqësuar nga Avokatura e Shtetit, ka paraqitur këto prapësime:

8.1 Pretendimi i kërkuarës për cenimin e të drejtës së pronës nuk mund të pranohet, pasi Gjykata Kushtetuese shqyrton ato kërkesa që lidhen me cenimin e të drejtës për një proces të rregullt.

8.2 Kërkuarësja pretendon se gjykatat nuk kanë vlerësuar dhe shqyrtuar provat e administruara dhe se janë mbështetur në një akt ekspertimi të jashtëligjshëm. Ky pretendim i kërkuarës, në fakt, i referohet çmuarjes që gjykatat i kanë bërë aktit të ekspertimit dhe, si i tillë, nuk hyn në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese. Është kompetencë e gjykatës që gjykon çështjen në themel, të vlerësojë nëse një akt ekspertimi është i mjaftueshëm së bashku me provat e tjera të administruara dhe, në këtë kuptim, edhe të vlerësojë nëse nevojitet kryerja e një akti të ri apo plotësimi i tij.

8.3 Kërkuarësja pretendon se gjykatat e kanë konsideruar padinë e parashkruar në kundërshtim me ligjin dhe se kanë dhënë vendime me kontradikta të brendshme. Ky pretendim është i pabazuar, pasi gjykatat nuk kanë përcaktuar një datë të njoftimit të aktit administrativ, i cili do të përbënte datën e fillimit të afatit të parashkrimit. Në lidhje me faktin nëse sheshi i ndërtimit mbivendoset me pronën që i është njohur kërkuarës, kontradikta që rezulton në vendimin e gjykatës së shkallës së parë është korrigjuar nga gjykata e apelit, e cila e ka bazuar arsyetimin e saj në faktin se mes pronave nuk ka mbivendosje.

8.4 I pabazuar është edhe pretendimi për cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar në Gjykatën e Lartë, pasi është kompetencë e Kolegjit Civil të asaj gjykate, në përputhje me nenin 480 të KPC-së, të vlerësojë nëse rekursi përmban shkaqe për kalimin e tij për shqyrtim në seancë gjyqësore.

8.5 Pretendimet e tjera të kërkuarës, që lidhen me pavlefshmërinë e vendimit të AKP-së dhe se gjykatat kanë dalë tej objektit të padisë, i takojnë themelit të çështjes, i cili nuk është objekt gjykimi në Gjykatën Kushtetuese dhe në këto pretendime nuk është evidentuar cenimi i ndonjë standardi të procesit të rregullt ligjor.

9. **Subjekti i interesuar, shoqëria "Baja" sh.p.k.**, ka paraqitur këto prapësime përpara Gjykatës:

9.1. Vendimet gjyqësore, të kundërshtuara nga kërkuarësja, të cilat kanë rrëzuar padinë e paraqitur prej saj, janë rrjedhojë e një procesi të rregullt ligjor. Gjatë gjyqimit të çështjes në gjykatat e faktit, kërkuarës i është

dhënë mundësia të dëgjohej, të mbrohet dhe i janë pranuar dhe shqyrtuar të gjitha provat e paraqitura. Gjykata, me iniciativë, ka caktuar edhe një grup ekspertësh, çka provon se ajo nuk është kufizuar në hetim vetëm në pretendimin e ngritur në proces nga ky subjekt lidhur me afatet prekluzive të ngritjes së padisë.

9.2. Moskthimi i një pasurie që përdoret për interes publik nuk është cenim i pronës, por në raste të tilla për pronarin lind e drejta kushtetuese për kompensim nga shteti.

9.3. Pretendimet për procedurën e caktimit të ekspertëve, mënyrës së marrjes në shqyrtim të aktit të ekspertimit dhe vlerësimit të tij, nuk mund të jenë objekt shqyrtimi nga Gjykata Kushtetuese. Këto pretendime janë trajtuar në gjykimin e zakonshëm dhe u është dhënë përgjigje përfundimtare.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Lidhur me legjitimitimin e kërkuësës

10. Gjykata Kushtetuese (Gjykata) vlerëson, paraprakisht, se kërkuësja legjitimohet *ratione personae*, në bazë të nenit 134/2, shkronja “g” të Kushtetutës, si edhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur brenda afatit të parashikuar nga neni 30, pika 2, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, në kuptim të nenit 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës, individit mund t’i drejtohet kësaj Gjykate për pretendime që lidhen me cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, kurse pretendimet që kanë të bëjnë me mënyrën e marrjes dhe vlerësimit të provave, interpretimin e ligjit material dhe procedural dhe zbatimin e tij në çështjet konkrete, janë çështje që bëjnë pjesë në juridiksionin e gjykatave të zakonshme. Gjykata vëren se kërkuësja ka pretenduar, mes të tjerash, se vendimet gjyqësore janë marrë në kundërshtim me ligjin, si dhe jashtë kontekstit të provave të administruara në dosjen gjyqësore. Ajo pretendon, gjithashtu, se gjykatat janë bazuar në një akt ekspertimi të pamiruar, se nuk kanë pranuar kërkesën për përsëritjen e tij si edhe se subjekti i interesuar, shoqëria “Baja” sh.p.k. ka shkelur ligjin për urbanistikën, duke dalë jashtë sheshit të ndërtimit dhe njollës së ndërtimit, në raport me lejen e sheshit dhe të ndërtimit të miratuar, çka ka sjellë mbivendosje me pronën e saj. Në lidhje me këto pretendime të kërkuësës, Gjykata vlerëson se ato nuk hyjnë në juridiksionin kushtetues dhe, për rrjedhojë, kërkuësja nuk legjitimohet *ratione materiae*, për sa kohë ajo nuk ka arritur t’i ngrejë ato në nivel kushtetues.

B. Lidhur me pretendimin për cenimin e të drejtës së aksesit në gjykatë

11. Kërkuësja pretendon se kërkesëpadia është paraqitur brenda afateve ligjore dhe se gjatë hetimit gjyqësor asnjë nga palët nuk arriti të provojë datën e marrjes dijeni prej saj të vendimit të organit administrativ të kundërshtuar. Po ashtu, ajo pretendon se konflikti gjyqësor i inicuar prej saj është një konflikt civil, ndaj kërkesa për zgjidhjen e tij nuk ka afat.

12. Gjykata ka theksuar se, bazuar në parimin *jura novit curia*, ajo mund të vlerësojë vetë nëse pretendimet e ngritura në kërkesë bien në fushën e veprimt të një dispozite të caktuar, që nuk është parashtruar para saj dhe nuk e konsideron veten të detyruar nga cilësimi që i është bërë fakteve të çështjes nga kërkuësi (*shih vendimet nr. 27, datë 9.5.2012; nr. 50, datë 9.5.2012; nr. 19, datë 25.4.2013; nr. 27, datë 24.6.2013 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se pretendimet e mësipërme të kërkuësës, duhet të trajtohen në këndvështrim të respektimit të së drejtës së aksesit në gjykatë, si pjesë e të drejtës për një proces të rregullt ligjor.

13. Administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t’i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv, dhe jo thjesht formal. E drejta për t’iu drejtuar gjykatës është një nga aspektet e së drejtës për gjykim, e sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës. Mohimi i së drejtës për t’iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj, për pretendimet e ngritura, përbën cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 7, datë 11.3.2008; nr. 14, datë 3.6.2009 të Gjykatës Kushtetuese*). Neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së sanksionojnë në vetvete jo vetëm të drejtën e individit për t’iu drejtuar gjykatës, por edhe detyrimin e shtetit që t’ia garantojë atij këtë akses. E drejta e aksesit në gjykatë mund t’i nënshtrohet kufizimeve deri në atë masë sa ato të mos cenojnë thelbin e kësaj të drejte. Në rast se mohohet një e drejtë e tillë, procesi konsiderohet i parregullt, sepse aksesit në gjykatë është, para së gjithash, një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera. Shteti i të drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t’iu drejtuar gjykatës (*shih vendimet nr. 18, datë 8.7.2009; nr. 4, datë 5.2.2014, të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Gjykata ka theksuar se mbrojtja kushtetuese dhe ligjore e të drejtave dhe lirive të individit mund të realizohet vetëm kur ushtrohet brenda afateve ligjore të përcaktuara. Përcaktimi i këtyre afateve nuk përbën një qëllim në vetvete, por bëhet për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve dhe në funksion të parimit të sigurisë juridike. Mospërcaktimi i këtyre afateve do të çonte në një situatë të tillë ku konfliktet gjyqësore asnjëherë nuk do të zgjidheshin përfundimisht mes palëve dhe situata e tyre do të ishte e pasigurt, pasi në çdo moment, një e drejtë e fituar me një vendim gjyqësor, potencialisht do të mund të cenohej apo prekej me një vendim të dhënë nga një gjykatë më e lartë (*shih vendimet nr. 5, datë 2.3.2010; nr. 38, datë 5.7.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, neni 328 i KPC-së, në fuqi në kohën e paraqitjes së padisë në gjykatë, parashikonte se “*Afati për paraqitjen e padisë ndaj një akti administrativ është 30 ditë nga dita e shpalljes ose e njoftimit të vendimit të organit më të lartë administrativ, që ka shqyrtuar ankesën në rrugë administrative, përveç kur ligji parashikon ankimin e drejtpërdrejtë në gjykatë...*”. Po ashtu, neni 18/2 i ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës” (i ndryshuar me ligjet nr. 9388, datë 4.5.2005 dhe nr. 9583, datë 17.7.2006), ka parashikuar një afat 30-ditor për kundërshtimin në gjykatë, të vendimit të AKKP-së për kompensim të pronës, nga ana e subjektit të shpronësuar.
15. Gjykata ka theksuar se kontrolli i kushtetutshmërisë së një vendimi gjyqësor vlerësohet në një kontekst të caktuar faktesh që lidhen me të drejtën për proces të rregullt ligjor. Rastet që i paraqiten Gjykatës mbi bazën e ankimit të individëve, duhet të shqyrtohen domosdoshmërisht në bazë të provueshmërisë së fakteve të dhëna. Marrja e vendimit për çështje kushtetuese kushtëzohet nga përcaktimi i fakteve kushtetuese, mbi bazën e të cilave vlerësohet respektimi i të drejtës për një proces të rregullt ligjor. Përdorimi i Gjykata Kushtetuese ka autoritetin për të vendosur përfundimisht për çështje të kushtetutshmërisë së procesit gjyqësor, ajo nuk mund ta ushtrojë këtë kompetencë pa analizuar faktet e natyrës kushtetuese (*shih vendimin nr. 5, datë 2.3.2010 të Gjykatës Kushtetuese*). Në gjykimin kushtetues u takon palëve, kërkuesit dhe subjektit të interesuar, të parashitrojnë argumentet faktike dhe ligjore mbi të cilat mbështesin pretendimet e tyre, pra është detyrë e palëve të shpjegojnë arsyet të cilat kanë çuar, sipas këndvështrimit të tyre, në shkelje të standardeve të procesit të rregullt ligjor.
16. Në këtë kuptim, Gjykata vëren se objekt i gjykimit të iniciuar nga kërkuesja është kundërshtimi i një akti administrativ, vendimi nr. 128, datë 31.5.2006 i KSHKKP-së, që ka rrëzuar kërkesën e saj për kthimin si truall të lirë edhe të një sipërfaqeje prej 400 m², brenda asaj të njohur për kompensim. Duke qenë se kjo padi ka të bëjë me kundërshtimin e një akti administrativ, gjykatat u janë referuar afateve ligjore për kundërshtimin e këtyre lloj aktesh. Lidhur me momentin e marrjes dijeni për aktin, nga ku fillon të rrjedhë edhe afati për ankimin e tij, Gjykata vëren se kërkuesja, edhe pse ka barrën e provës për të provuar pretendimet e saj, nuk ka paraqitur asnjë provë, me anë të së cilës të provojë momentin e marrjes dijeni efektivisht, prej saj, të aktit të kundërshtuar, me qëllim që të argumentojë se ka respektuar afatin ligjor 30-ditor, për t’iu drejtuar gjykatës, çka do të sillte, për pasojë, edhe cenimin e vendimeve gjyqësore të kundërshtuara.
17. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkueses, për cenimin e të drejtës së aksesit në gjykatë, është haptazi i pabazuar.

C. Lidhur me pretendimin për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor

18. Kërkuesja pretendon se vendimet gjyqësore kanë kontradikta në arsyetimin e tyre, pasi fillimisht shprehen se mes pasurive nuk ka mbivendosje dhe, më pas, për të njëjtat pasuri, shprehen se ka mbivendosje.
19. Në jurisprudencën e saj, Gjykata ka theksuar domosdoshmërinë e arsyetimit të vendimeve gjyqësore, si një garanci për procesin ligjor. Vendimet gjyqësore që japin gjykatat e të gjitha niveleve në përfundim të gjykimit, përbëjnë aktin procedural kryesor të të gjithë procesit gjyqësor. Ato përmbledhin dhe finalizojnë përfundimisht qëndrimet që mban gjykata lidhur me çështjen në gjykim. Gjykata ka theksuar se vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes (*shih vendimet nr. 11, datë 2.4.2008; nr. 23, datë 4.11.2008; nr. 7, datë 9.3.2009; nr. 8, datë 16.3.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre dhe ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë dhe duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradiksion të hapur ose të fshehtë (*shih vendimet nr. 38, datë 30.12.2010; nr. 20, datë 13.4.2012; nr. 3, datë 19.2.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).
20. Zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme

detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre. Në këtë kontekst, Gjykata ka theksuar se ajo e vlerëson arsyetimin e një vendimi gjyqësor vetëm në kuadrin e përmbushjes ose jo të standardeve të mësipërme, pasi nuk është detyrë e saj të analizojë provat dhe faktet ku është bazuar gjykata për zgjidhjen e çështjes së themelit. Kjo mbetet detyrë funksionale e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm dhe, në aspektin e kontrollit kushtetues, Gjykata verifikon nëse arsyetimi i vendimit gjyqësor i ka plotësuar ose jo kriteret e përcaktuara më sipër, të cilat garantojnë të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar (*shih vendimet nr. 55, datë 18.12.2012; nr. 3, datë 19.2.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Në çështjen konkrete në shqyrtim, rezulton se gjykatat e zakonshme, me arsyetimin se vendimi i organit më të lartë administrativ mban datën 31.5.2006, kurse kërkesë padia objekt gjykimi është paraqitur në datën 23.4.2007, pra jashtë afatit ligjor, kanë vlerësuar se ajo është parashkruar. Megjithatë, gjykatat e kanë shqyrtuar në themel kërkesë padinë dhe kanë vlerësuar, në përfundim të gjykimit, se ajo është edhe e pambështetur në ligj e në prova. Lidhur me përfundimet e aktit të ekspertimit, në vendimin e saj gjykata e shkallës së parë shprehet, fillimisht, se pronat nuk kanë mbivendosje, kurse më pas shprehet se ato kanë mbivendosje për 3 m², fakte këto që, sipas kërkuësës, janë kontradiktore dhe përbëjnë cenim të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor. Gjykata vëren se, konflikti gjyqësor i inicuar nga kërkuësja ka të bëjë me kthimin, si truall të lirë, të një sipërfaqeje prej 200 m², të përfshirë në atë pjesë të pasurisë që u është kompensuar pronarëve, kërkesë që është refuzuar për shkak se kjo sipërfaqe është e zënë me ndërtim të përhershëm, pra është sipërfaqe funksionale e tij. Është kjo sipërfaqe për të cilën, bazuar në konkluzionet e aktit të ekspertimit, gjykata shprehet se nuk ka mbivendosje. Fakti se gjykata e shkallës së parë shprehet, në vijim, për një mbivendosje në një sipërfaqe prej 3 m², nuk e bën vendimin alogjik, pasi ky fakt nuk sjell asnjë pasojë në konkluzionin e arritur më parë prej saj, lidhur me thelbin e çështjes.

22. Për më sa më sipër, Gjykata vlerëson se, në rastin konkret, nuk rezulton që vendimi i kundërshtuar të jetë jologjik, të ketë kundërthënie, të mos ketë referencë në ligjin e zbatueshëm dhe të mos respektojë elementet e përmendura më sipër. Për rrjedhojë, ky pretendim i kërkuësës është i pabazuar.

D. Lidhur me pretendimin për procesin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë

23. Kërkuësja pretendon se Gjykata e Lartë nuk ka vlerësuar pretendimet e paraqitura në rekurs, ndaj dy vendimeve gjyqësore të zhvilluara me shkellje të rënda procedurale, të cilat përbëjnë shkak për të prishur ato vendime dhe për të kthyer çështjen për rigjykim në shkallë të parë.

24. Për sa i përket shqyrtimit të rekursit në Gjykatën e Lartë, neni 480 i KPC-së parashikon se Kolegji Civil, në dhomën e këshillimit, është organi që analizon dhe vlerëson nëse shkaqet e ngritura në rekurs janë në përputhje me kërkesat e ligjit, duke vlerësuar kështu nëse rekursi përmban shkaqe për t'u kaluar për shqyrtim në seancë gjyqësore. Sikundër për pranimin, ashtu edhe për mospranimin e rekursit, dhoma e këshillimit, nëpërmjet arsyetimit të vendimeve të saj, luan rolin e një filtri të kërkesave që i drejtohen Gjykatës së Lartë. Në rast se Kolegji, në dhomën e këshillimit, krijon bindjen se shkaqet e ngritura në rekurs objektivisht nuk gjejnë mbështetje në aktet e administruara në dosjen gjyqësore, atëherë është në kompetencën e tij të vendosë, në pajtim me kërkesat ligjore, mospranimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore. Nga pikëpamja kushtetuese, vetëm kur janë të pranishme pretendime që kanë të bëjnë me shkelljen e parimeve themelore të procesit civil, si dhe kur këto pretendime gjejnë pasqyrim në materialet e çështjes, vendimi i Kolegjit Civil për mospranimin e rekursit vë në dyshim të drejtën për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimin nr. 22, datë 6.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Në rastin konkret, Gjykata vlerëson se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në përputhje me kompetencat e tij ligjore, pasi ka marrë në shqyrtim në dhomë këshillimi shkaqet e paraqitura nga kërkuësja në rekurs, ka vlerësuar se ato janë të pabazuara. Në këto kushte, Gjykata vlerëson se, për sa kohë që pretendimet e kërkuësës që lidhen me procesin e zhvilluar në gjykatat e faktit janë të pabazuara, edhe mospranimi i rekursit në dhomë këshillimi nuk përbën cenim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja “f” dhe nenit 134, pika 1, shkronja “g” të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Vladimir Kristo, Gani Dizdari, Altina Xhoxhaj, Fatos Lulo, Besnik Imeraj

Anëtarë kundër: Bashkim Dedja, (kryetar), Sokol Berberi, Fatmir Hoxha, Vitore Tusha

MENDIM PAKICE

1. Për arsye se nuk ndajmë të njëjtin qëndrim me shumicën, lidhur me përfundimin e arritur në këtë çështje dhe argumentet mbi të cilat mbështetet ky qëndrim, e çmojmë të rëndësishme të shprehemi me mendim pakice.

2. Shumica ka argumentuar se fakti që gjykata e shkallës së parë shprehet për një mbivendosje në një sipërfaqe prej 3 m², nuk e bën vendimin jologjik, pasi ky fakt nuk sjell asnjë pasojë në konkluzionin e arritur më parë prej saj, lidhur me thelbin e çështjes. Bazuar në këtë qëndrim ajo e ka vlerësuar të pabazuar pretendimin e cenimit të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, pasi sipas saj, në rastin konkret, nuk rezulton që vendimi i kundërshtuar të jetë jologjik, të ketë kundërthënie, të mos ketë referencë në ligjin e zbatueshëm dhe të mos respektojë elementët e trajtuar nga jurisprudenca kushtetuese (prg. 21 - 22 të vendimit). Nuk pajtohemi me këtë përfundim të shumicës për arsye të mëposhtme.

3. Siç është shprehur edhe shumica, Gjykata, në jurisprudencën e saj, të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar e ka konsideruar pjesë përbërëse dhe të pandarë të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të neneve 42, 142/1 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (*shih vendimet nr. 4, datë 5.2.2014 dhe nr. 55, datë 18.12.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë. Ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradiksion të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë gjithashtu të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese. Konkluzionet e pjesës arsyetuese duhet të bazohen jo vetëm në aktet ligjore, por edhe në parimet dhe rregullat që karakterizojnë mendimin e shëndoshë e logjik (*shih vendimet nr. 20, datë 13.4.2012 dhe nr. 38, datë 30.12.2010 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka vënë në dukje, se ajo e vlerëson arsyetimin e një vendimi gjyqësor vetëm në kuadrin e përmbushjes ose jo të standardeve të mësipërme dhe nuk është detyrë e saj të analizojë provat dhe faktet ku është bazuar gjykata për zgjidhjen e çështjes së themelit (*shih vendimin nr. 55, datë 18.12.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

4. Në rastin konkret rezulton se gjykata e shkallës së parë edhe pse ka vlerësuar se padia e ngritur nga kërkuesja ishte parashkruar, për shkak të paraqitjes së saj jashtë afatit ligjor, është shprehur edhe mbi themelin e çështjes, duke arritur në përfundimin se padia është e pambështetur në ligj e në prova. Po të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe gjykata e apelit, e cila nga njëra anë i ka vlerësuar të parashkruara kërkimet e paraqitura nga kërkuesja dhe nga ana tjetër është shprehur mbi themelin e çështjes. Referuar përmbajtjes së vendimit gjyqësor nr. 5150/2008, gjykata e shkallës së parë, megjithëse ka konstatuar mosrespektimin e afatit ligjor për paraqitjen e padisë, nuk e ka rrëzuar padinë për këtë shkak, por ka vijuar me vlerësimin në thelb të çështjes duke arritur në konkluzionin se prona e pretenduar nga kërkuesja dhe ajo ku po ndërton subjekti i interesuar nuk kanë mbivendosje. Kjo kontradiktë në arsyetim nuk është korrigjuar as nga gjykata e apelit, e cila ka mbajtur të njëjtin qëndrim për sa i përket parashkrimit të padisë dhe përfundimit se pronat nuk kanë mbivendosje. Për më tepër, duke u shprehur edhe mbi themelin, gjykatat kanë cenuar të drejtën e aksesit pasi, në qoftë se do të rivendosej në afat e drejta e parashkruar, gjykata nuk mund të gjykojë përsëri mbi themelin, në kushtet kur është shprehur njëherë në lidhje me të.

5. Gjithashtu, nga aktet e dosjes vërejmë që ekspertët e Komitetit Shtetëror të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (KSHKKP) kanë konstatuar se “nga krahasimi i planvendosjes së sipërfaqes prej 346 m² dhe planvendosjes së sheshit të ndërtimit rezulton një mbivendosje prej 200 m². Sipërfaqja prej 346 m² ndodhet brenda sipërfaqes prej 13.614,7 m² e miratuar për kompensim me vendimin nr. 283/2000 të KKKP-së” (*shih vendimin nr. 128/2006 të KSHKKP-së*). Megjithëse ky konkluzion është i ndryshëm nga ai në të cilin kanë arritur ekspertët e caktuar nga gjykata, kjo e fundit nuk është shprehur në vendim mbi këtë çështje dhe nuk e ka pranuar kërkesën e paraqitur nga kërkuesja për ribërjen e aktit të ekspertimit. Për më tepër, ky vendim i gjykatës së shkallës së parë ka kundërthënie edhe për faktin se ndërkohë që arrihet në konkluzionin se “nuk ka mbivendosje”, njëkohësisht

pranohet se “rezulton një mbivendosje (...) në total 3 m² me pronën e pretenduar nga paditësja”. Ndonëse në ankim kërkesja ka ngritur pretendime në drejtim të marrjes së vendimit në kundërshtim me ligjin dhe provat e administruara në gjykim, parregullsive formale e konkluzioneve jo të drejta të aktit të ekspertimit, si dhe në lidhje me mbivendosjen e pronës, gjykata e apelit nuk i ka dhënë përgjigje këtyre pretendimeve, duke cenuar standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor. Vlen të përmendet, ndër të tjera, se gjykata e apelit jo vetëm nuk është shprehur për pretendimet ndaj aktit të ekspertimit, të cilin kërkesja e ka goditur nga pikëpamja formale dhe substanciale, por është mbështetur gjatë arsyetimit në konkluzionin e arritur në këtë akt. Gjithashtu, arsyetimi i gjykatës së apelit nuk e plotëson kriterin e qartësisë në përmbajtje pasi edhe pse i referohet përfundimit të arritur nga organi kompetent shtetëror, në lidhje me sipërfaqen prej 200 m², objekt padie, nuk shprehet se cili është ky organ dhe cili është konkretisht përfundimi në të cilin ai ka arritur (fq. 4, prg. 7 i vendimit të gjykatës së apelit).

6. GJEDNJ-ja, në jurisprudencën e saj ka nënvizuar se, detyrimi i gjykatave për të arsyetuar vendimet e tyre nuk do të thotë dhënie përgjigje për çdo çështje/argument të ngritur nga pala për të mbështetur mbrojtjen e saj. Fushëveprimi/shtrirja e këtij detyrimi mund të ndryshojë në varësi të natyrës së vendimit. Për të respektuar parimin e procesit të rregullt ligjor, arsyetimi duhet të demonstrojë që gjyqtari/gjykata ka shqyrtuar realisht të gjitha çështjet kryesore që janë ngritur përpara tij/saj (shih çështjet *Boldea kundër Rumanisë*, 15 shkurt 2007 § 29 dhe *Helle kundër Finlandës*, 19 shkurt 1997, § 60).

7. Megjithëse gjatë gjyimit në apel nuk është respektuar standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor, siç është vlerësuar më sipër, vërejmë se këto shkelje nuk janë konstatuar nga Gjykata e Lartë, në ushtrimin e rolit të saj si gjykatë e ligjit dhe kontrollit për respektimin e standardeve kushtetuese nga gjykatat më të ulëta.

8. Për sa më lart, vlerësojmë se, në rastin konkret, nuk janë përmbushur kriteret e një vendimi gjyqësor të arsyetuar. Gjykatat, në të tre shkallët e gjyimit nuk kanë garantuar zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, ndaj çmojmë se, pretendimi i kërkeses për sa i përket cenimit të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor është i bazuar dhe vendimet gjyqësore, objekt shqyrtimi, duheshin shfuqizuar.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Vitore Tusha, Fatmir Hoxha, Sokol Berberi